

**‘Statuti’ dhe ‘Akti i Themelimit’ i ‘Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar’
“SIRIONIX” sh.p.k**

Forma e Shoqerise

Neni 1

Sot me 30.10.2022 une themeluesi Daniel Xhelaj, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“SIRIONIX ” sh.p.k.**

Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo ceshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Themeluesi i shoqerise eshte:

1. Daniel Xhelaj, shtetas shqiptar, i datelindjes 31.07.1987, lindur ne Patos, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten numer BC3485087 dhe numer personal I70731089U.

Qendra e Shoqerise

Neni 2

Adresa : Komuna e Parisit, Rruga Frang Bardhi, Kristal Center, Kati i Dyte, Tirane, Shqipëri
e-mail i shoqerise: ceo@sirionix.com

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Programimi dhe zhvillimi i software, website, sherbime pagesash, sherbime financiare dhe menaxhimi, zhvillim i lojrave, sherbime ligjore dhe komerciale, manaxhim ne distance dhe asistence ne sherbime, ndermjetes ne sherbimet B2B.

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

Kapitali i shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000(njeqindmije) leke .

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 100,000 leke. Kjo kuote i perket ortakut te vetem si me poshte:



1. Daniel Xhelaj, zoterues e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100,000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.
Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 8

Ortaku i shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tij nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve si dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Kompetencat e ortakeve

Neni 11

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, ortaku shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.

Kane te drejte te miratojne bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.

Ata emerojne administratoret, zevendesit, ekspertet dhe revizoret kontabel.

Ata aprovojne cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencat e tyre.

Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.

Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.

Bejne transferimin e kuotave te te tretet.

Bejne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.

Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise.

Kane te drejte te bejne modifikimin e kontrates se shoqerise, etj.



Neni 12

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Administrimi

Neni 13

Administrator i shoqerise eshte Daniel Xhelaj, shtetas shqiptar, i datelindjes 31.07.1987, lindur ne Patos, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten numer BC3485087 dhe numer personal I70731089U.

Afati i mandatit eshte 5 (pese) vjet.

Neni 14

Administratori mund te emeruje nje ose me shume administrator te deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje regullore te brendshme te shoqerise.

Neni 15

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe Statut qe I takojne ortakeve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

Marredheniet e punes

Neni 16

Marredheniet e punes regullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Ekspertet ose revizoret kontabel

Neni 18



Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise I besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Viti financiar, bilanci vjetor, shperndarja e fitimeve **Neni 19**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti I pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit. Miratimi i dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 muajve qe nga fundi I vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet **Neni 20**

Veprimtaria ekonomike do te mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten I kalojne ortakeve te shoqerise.

Neni 21

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

Shperndarja dhe likuidimi i shoqerise **Neni 22**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqerise **Neni 23**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve te administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.





Dispozita te pergjitheshme

Neni 24

Per sa esht shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjit 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Statutit dhe regullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

**Ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“SIRIONIX” sh.p.k**

Z. Daniel Xhelaj



Tirane, me 30.10.2022